



MUNICIPAL PERFORMANCE GRANT  
GRANTI I PERFORMANCËS KOMUNALE  
OPŠTINSKI GRANT UČINKA



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministartstvo Administracije Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration

30 Gusht 2022

**Lënda:** Informatë lidhur me aplikimin e kushteve minimale për grantin e performancës komunale 2023

I nderuar Kryetar,

Së pari, shfrytëzoj rastin të vlerësoj përpjekjet e juaja për të përmirësuar performancën e komunës suaj dhe për të raportuar saktë dhe me kohë të dhënat në Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK). Kjo dëshmon se SMPK dhe Granti i Performancës Komunale (GPK) është duke patur ndikim në komuna dhe si rrjedhojë do të ndihmojë në përmirësimin e kualitetit të jetesës për qytetarët e Kosovës. GPK ua ka mundësuar komunave që të financojnë projekte të rëndësishme kapitale të cilat janë vitale për një rritje dhe zhvillim të vazhdueshëm të komunës suaj. Ju përgëzoj për dedikimin e tuaj për jetësimin e këtyre projekteve.

Së dyti, ju informoj se procesi i vlerësimit të performancës për grantin e vitit 2023 është në fazën fillestare. Vlerësimi i performancës së vitit 2021 në SMPK është në perfundim dhe raporti i performancës do të publikohet gjatë javëve në vijim. Njëherësh, më lejoni t'ju falenderoj për bashkëpunim dhe ngritje të shqetësimeve lidhur me kushtet minimale të GPK-së. E vlerësojmë jashtëzakonisht komunikimin lidhur me këtë çështje, dhe për këtë dëshiroj të ofroj disa sqarime.

MAPL me përkrahje të projektit DEMOS dhe donatorëve të GPK-së, ka analizuar ndër të tjera të dhënat sidomos lidhur me shkallën e shpenzimit të buxhetit për investime kapitale duke pasur parasysh që: i) viti 2021 ka qenë vit zgjedhor dhe ii) Organi Shqyrtues i Prokurimit nuk ka qenë funksional gjatë pjesës më të madhe të vitit. Po ashtu, kemi analizuar raportet e auditimit dhe e kemi konsultuar në mënyrë të veçantë me Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Nga të dhënat të cilat i kemi siguruar lidhur me shpenzimin e buxhetit si dhe të dhënat publike të ankesave tek OSHP, nuk ka evidencë që viti zgjedhor ose ankesat e pazgjithura në OSHP të kenë patur ndikim të rëndësishëm në përmbushjen e kushteve minimale në GPK.

Në vijim kemi analizuar edhe shkaqet e kualifikimit të opinionit të auditimit të komunave. Çështjet sikurse keqklasifikimi i shpenzimeve, regjistrimi jo i plotë ose i pasaktë i aseteve dhe çështjet lidhur me obligimet kontigjente janë çështje thelbësore të cilat duhet të adresohen jo vetëm që komunave t'iu garantohej besueshmëria e mjeteve nga donatorët dhe Qeveria, por edhe për të përmirësuar qeverisjen e

komunave. Këto çështje lidhen ngusht me synimet e GPK-së dhe kërkojnë vëmendje shtesë nga komunat në periudhën vijuese.

Duke marr parasysh çështjeve të theksuara si më lartë, por edhe në bazë të konsultimeve me donatorë, kemi vendosur që për grantin e vitit 2023 kushtet minimale të aplikohen siç kanë qenë për vitin 2022. Zbatimi i 4 kushteve shërben si garanci për komunitetin e donatorëve që komunat përfituese i kanë kapacitetet për të shfrytëzuar grantin në mënyrë efektive dhe në përputhje me ligjet në fuqi.

Gjithashtu, vijueshmëria kushteve minimale të pandryshuara na jep shpresë se do të shërbej si motiv për komunat të cilat kanë bërë përpjekje të jashtëzakonshme dhe përkundër sfidave, kanë arritur t'i përmbushin të gjitha kushtet minimale.

Ne jemi të përkushtuar që, së bashku me projektin DEMOS, të ofrojmë përkrahje shtesë komunave për të adresuar mangësitë e identifikuar në opinionin e auditmit.

Gjatë vitit 2023, do të bëhet një analizë e dizajnit të grantit, duke i përfshirë kushtet mininale. Kjo analizë do të bëhet në bashkëpunim me komunat, gjë e cila si pasojë mund të sjell ndryshime në vitet vijuese.


Mbesim në dispozicion që së bashku të adresojmë çdo çështje e cila ndikon në punën tuaj në shërbim të qytetarëve dhe të punojmë në adresimin e të gjitha mangësive, në mënyrë të tillë që sa më shumë komuna e qytetarë të përfitojnë në të ardhmen nga GPK.

Me respekt,  
Elbert Krasniqi  
Minister, MAPL

Kopje:  
Venera Çerkini  
Diellor Gashi  
Donatoret  
DEMOS



Co-funded by  
the European Union



Sweden  
Sverige



Norwegian Embassy